



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË - DEGA E GJYKATËS KLINË

Numri i lëndës: 2019:280146

Datë: 08.07.2020

Numri i dokumentit: 01014422

C.nr.564/19

GJYKATA THEMELORE PEJË-DEGA NË KLINË -Departamenti i Përgjithshëm Divizioni Civil- më gjyqtarit Prenk Palushi,dhe asistentën administrative Violeta Lecaj- Lulaj duke vendosur në çështjen juridiko-civile të paditësit: P. M. G nga fsh.K. e M. K .Klinë, kundër të paditurit D. Zh.nga fsh.K. M, K.Klinë me vendbanim K. R.e Serbisë Rr. “Z. nr.... të cilin e përfaqëson av.Hil Prenaj me autorizim në shkresa të lëndës, baza juridike: vërtetim i pronësisë, vlera e kontestit 3.000 euro, pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit kryesor me dt.30.06.2020, në të cilët prezantuan paditësit, si dhe i autorizuari i të paditurit, me dt.08.07.2020 bijë këtë:

A K T G J Y K I M
në bazë të pohimit

- I. APROVOHET SI E BAZUAR-**Kërkesëpadia e paditësit: P. M. G nga fsh.K. M, K.Klinë .
- II. VËRTETOHET- se:** P. M. G nga fsh.K. M, K.Klinë, është pronar i paluajtëshmërisë të shtrirë në parcelën kadastrale :P71011049-.....-... Z.K.K. M,K.Klinë në sipërfaqe prej ...m2. në vendin e quajtur L. U, cila në certifikatën e pronës evidentohet ne emër te Zh. D. P, Zh. Zh. P, Zh. M. P, ne bashkëpronësi me nga 1/3 në pjesë ideale.
- III. OBLIGOHET** – i padituri që të drejtën e pronësisë në paluajtëshmerin e theksuar si më lartë të ja njoh dhe pranoj palës paditëse, në atë mënyrë që i njëjti të përmbahet lidhur më regjistrimin e të drejtës se pronësisë së paditësit në regjistrin e të drejtave për pronë të paluajtshme të Drejtorisë për Gjeodezi Kadastër e Pronësi K.Klinë, dhe këtë në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi nën kërcënimin e përmbarimit ligjor.
- IV. Shpenzimet procedurale i bart pala** paditëse

A r s y e t i m

Paditësi: P. M. G nga fsh.K. M,K.Klinë ,në shqyrtimin kryesor si dhe në fjalën përfundimtare deklaron se paluajtëshmerinë lëndore qe është objekt i kërkesëpadisë e cila shtrihet në parcelën kadastrale 00...-... në sipërfaqe prej ...m2 ,ZK. K. M, e cila ne certifikatën e pronës evidentohet në emër të Zh. D. P, Zh. Zh. P, Zh. M. P, në bashkëpronësi me nga 1/3 në pjesë ideale, me dt.-...-... e kamë blerë nga shitësi këtu i padituri Zh. Zh. D, me çmimin prej ..., ... euro të cilin çmim blerës shitësit –të paditurit ja kamë paguar menjëherë në tërësi, me ç’rast kam hyrë në posedim dhe shfrytëzim të lirë të paluajtëshmerisë lëndore ,duke shfrytëzuar te njëjtën pa pengim nga askush qe nga ajo kohë e deri me sot ,mirëpo për shkaqe të ndryshme objektive, të njëjtën parcelë nuk kam pasur mundësi në drejtorinë përkatëse ta regjistroj në emër timin .Duhet theksuar që shitësi –i padituri D. Zh. Zh, është i biri i Zh. Zh. në emër te të cilit me 1/3 evidentohet

paluajtshmeria lëndore ,të cilën paluajtshmeri i padituri –shitësi qysh në vitin 1985 e ka trashëguar me rastin e ndarjes se bashkësisë familjare sipas të drejtës trashëgimore, fakte të cilat vërtetohen në bazë të kontratës të shkruar dhe të nënshkruar nga palët kontraktuese por të pa vërtetuara nga organi kompetent i dt....-...-.... Përfundon duke i propozuar gjykatës që të aprovojë padinë dhe kërkesën e saj si të bazuar.

I autorizuari i të paditurit në seancën e shqyrtimit kryesor si dhe në fjalën përfundimtare deklaronë se: mbetem në tërësi pranë përgjigjes në padi, me këtë përgjigje ja pranoj padinë dhe kërkesëpadinë, paditësit në tërësi për faktin se i padituri njësinë kadastrale 00...-..., ja ka shitur me dt....-...-..., dhe e ka pranuar në tërësi mjetet financiare në shumën prej euro .I padituri ka qenë pronar faktik nga baza e ndarjes të bashkësisë së gjerë familjare në vitin Andaj pasi qe i padituri e ka pohuar dhe pranuar se të njëjtën parcelë e ka shitur paditësit dhe ja ka lenë në posedim dhe shfrytëzim , i propozoj gjykatës qe te ja aprovoj kërkesëpadinë e paditësit.

Me pohimin e fakteve nuk është e nevojshme gjykata ti provoj te njëjtat ndërkaq me pranimin e kërkesëpadisë pushon nevoja e zbatimit te se drejtës materiale në gjendjen e konstatuar faktike ,mirëpo gjykata zbaton procedurën e provave për te vërtetuar drejt dhe në mënyrë të plotë gjendjen faktike ,gjatë të cilës lexon prova materiale si në vijim :Në bazë te certifikatës se pronës P-71011049-.....-..... te dt....-...-... e leshuar nga Drejtoria GJ.K.P.Klinë verteohet se paluajtshmeria lëndore në sipërfaqe prej ...m2 ZK.K. M, vendi i quajtur lagja e ulët është e evidentuar në emër te Zh. D. P, Zh. M. P, Zh. Zh. P, në bashkëpronësi sipas pjesëve ideale me nga 1/3 në pjesë ideale, lexohet kontrata mbi shitblerjen e paluajtshmerisë lëndore e dt....-...-... e nënshkruar nga Zh. Zh. në cilësinë e shitësit në njërën anë dhe në anën tjetër P. G. në cilësinë e blerësit, lexohet aktvendimi nr...../..., i dt...-...-.....

Konform dispozitave ligjore të nenit 3.3 gjykata vijë deri të përfundimi se palët ndërgjyqëse në këtë qeshtje juridiko civile kanë të drejtë të disponojnë lirisht me kërkesat e tyre, si dhe të ndërmarrin veprime disponibile në këte çeshtje juridiko civile më që të njëjtat nuk janë në kundërshtim me rendin juridik, dispozitat ligjore, dhe rregullat e moralit publik, andaj në kuptim të dispozitave ligjore të lartcekura si dhe konform nenit 148 të LPK-së gjykata bije aktgjykim në bazë të pohimit ,më që pala e paditur përmes të autorizuarit të saj e pohon në tërësi kërkesëpadinë.

Andaj duke u mbështetur në dispozitat ligjor të larte theksuara në çeshtjen konkrete juridiko-civile ,gjykata vije deri të përfundimi se pala paditëse ka fituar të drejtën e pronësisë në bazë të veprimit juridik– kontratës me shkrim , në bazë të se cilës te dy palët kontraktuese kanë shprehur vullnetin e tyre të plotë për elementet themelore të kontratës.

Konform dispozitave ligjore të nenit 20 të ligjit mbi marrëdhëniet juridike pronësore e drejta e pronësisë fitohet sipas vet ligjit ,në bazë të veprimit juridik dhe me trashëgimi .E drejta e pronësisë fitohet edhe me vendimit të organit shtetëror në kushtet dhe mënyrën e caktuar me ligj .Sipas vet ligjit e drejta e pronësisë fitohet me krijimit të sendit të ri me bashkim, më përzierje ,me ndertim në token e huaj ,me ndarjën e fryteve ,me parashkrim fitues, fitim të pronësisë nga jo pronari ,me okupim dhe në rastet e tjera të caktuara me ligj.

Në çeshtjen konkrete juridiko civile paditësi të drejtën e pronësisë në paluajtshmerinë lëndore e ka fituar me punë të vlefshme juridike –kontratë mbi shitblerjën ,e cila kontratë pasi qe është përmbushur në tërësi nga palët kontraktuese ,në kuptim të dispozitave ligjore të nenit 73 të LMD-së konvalidohet , e të cilat dispozita ligjore përcaktojnë” Kontrata për lidhjen e së cilës kërkohet forma shkresore quhët e plotëfuqishme, megjithëse nuk është lidhur në këtë formë në qoftë se palët kontraktuese i kanë zbatuar

në tërësi ose në pjesën predominuese detyrimet që dalin nga ajo, përveç në qoftë se nga qëllimi për të cilin është parashikuar forma është e qartë se nuk ekziston diçka tjetër”.

Gjykata në bazë të provave materiale të nxjerra dhe administruara ne shqyrtim kryesor vertetohet legjitimitetin real pasiv e palës së paditur në këtë qeshtje juridiko civile.

Konform dispozitave ligjore të nenit 452 të LPK-së u vendos për shpenzime procedurale sikurse në pikën 4 te dispozitivit të këtij aktgjykimit.

Andaj nga arsyet e theksuara më lartë konform dispozitave ligjore të nenit 142 dhe 148 të LPK-së u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PEJË – DEGA NË KLINË
Departamenti i Përgjithshëm –Divizioni Civil
C.nr.564/19, me dt. 08.07.2020

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi mund të ngritët ankesë në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së të njëjtit, gjykatës së Apelit në Prishtinë përmes kësaj gjykate.

G j y q t a r i
Prenk Palushi

Numri i lëndës: 2019:280146
Datë: 08.07.2020
Numri i dokumentit:01014422